

Gjykata Supreme e Kosovës
Pkl-Kzz 119/09
20 janar 2010
Prishtinë

Gjykata Supreme e Kosovës

në kolegjin e përbërë në përputhje me nenin 26 paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (“KPPK”), dhe nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (“Ligji mbi Kompetencat”), të përbërë nga Gjyqtarja e EULEX-it Maria Giuliana Civinini si Kryetare e Kolegjit, Gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger dhe Gjyqtarët e Gjykatës Supreme Zait Gjemajli, Avdi Dinaj dhe Gjuran Demaj si anëtarë të kolegjit, të asistuar nga Edita Kusari, Këshilltare Ligjore e EULEX-it, si procesmbajtëse dhe Mentor Osmani, përkthyes i EULEX –it

;

Në lëndën kundër të akuzuarit:

Mehmet Morina, me nofkën Meha, Shqiptar i Kosovës, emri i të atit: Seidi Morina mbiemri i vajzërisë i së ëmës: Nazime Shabani, punëtor në autolarje, me banim në rrugën Besa # 21, Fushë Kosovë, i lindur më 11 gusht 1976, në Fushë Kosovë, i pamartuar, nuk ka të kryer shërbimin ushtarak, me gjendje të mesme ekonomike, di lexim por nuk di shkrim, është në paraburgim që nga data 19 prill 2004, aktualisht në Burgun e Dubravës;

I akuzuar për vepër penale të:

Vrasje në tentativë, në kundërshtim të nenit 30 paragrafit (2) pikat 1) dhe 5) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK), lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, (KP RSFJ), lidhur me nenin 147 paragrafët (5) dhe (6) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), dhe nenin 2 paragrafin (1) dhe nenin 23 të KPK-së;

Duke vepruar mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur më 12 tetor 2009 nga ana e avokatit mbrojtës të të pandehurit dhe asaj të paraqitur më 10 nëntor 2009 nga ana e Prokurorit Publik të Kosovës kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, **Ap.-Kž. Nr. 165/2007**, të datës 19 maj 2009

Lëshon këtë

AKTGJYKIM

-Refuzohet Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit Mehmet Morina dhe refuzohet Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shtetit si të pabazuara dhe vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 456 të KPPK-së



ARSYETIM

Historia e procedurës

Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin e datës 22 korrik 2005 shpalli Mehmet Morinën fajtor për vepër penale të Vrasjes në tentativë të Zlatibor Trajkovic-it të kryer më 17 mars 2004 në bashkëpunim me persona tjerë dhe në ndihmë dhe nxitje të njëri tjetrit në shkelje të nenit 30 § 2 n° 1 dhe 5 të LPK-së lidhur me nenin 22 të KPRSFJ-së dhe nenin 147, § 5 dhe 6 të KPPK-së lidhur me nenin 2 dhe 23 të PKKP-së. Gjykata e shpalli atë të pafajshëm për akuzën e Pjesëmarrjes në grup që kryen vepër penale.

Mehmet Morina u dënua me 18 vjet burgim, në të cilin dënim është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim.

Prokurori publik paraqiti ankesë më 19 tetor dhe nga i pandehuri më 16 tetor 2006. Prokurori paraqiti përgjigje më 4 nëntor 2008.

Dosja u transferua nga Gjyqtarët e UNMIK-ut tek Gjyqtarët e EULEX-it më 6 janar 2009.

Gjykata Supreme, në kolegjin e përbërë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe tre gjyqtarë vendorë, me aktgjykimin e datës 19 maj 2009, refuzoi ankesën e Prokurorit publik dhe pjesërisht pranoi ankesën e avokatit mbrojtës. Gjykata Supreme ndryshoi aktgjykimin sa i përket cilësimit të veprës penale për të cilën Mehmet Morina është shpallur fajtor për Vrasje të rëndë në tentativë në bashkëpunim me persona tjerë, të përcaktuar me nenin 30 paragrafin (2) pikën 3) të LPK-së në lidhje me nenet 19 dhe 22 të KPRSFJ-së. I pandehuri u dënua me dymbëdhjetë (12) vjet burgim në të cilin dënim është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 19 prill 2004.

Avokati mbrojtës i të pandehurit ka paraqitur një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër këtij aktgjykimi më 12 tetor 2009 kurse Prokurori publik i Kosovës ka paraqitur një kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë më 10 nëntor 2009.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur në emër të të pandehurit pretendon në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penale. Në veçanti, avokati mbrojtës:

1) kundërshton përbërjen e kolegjit në shkallën e parë (që është dashur të jetë i përbërë nga tre gjyqtarë profesionalë dhe dy gjyqtarë porotë, kurse ishte i përbërë nga tre gjyqtarë profesionalë ndërkombëtarë) dhe në shkallën e dytë (i përbërë nga pesë gjyqtarë që është në kundërshtim me dispozitën e nenit 4.7 të Ligjit mbi Kompetencat). Sipas avokatit mbrojtës, me këtë kolegji ka bërë shkelje esenciale të nenit 403 par. 1 pikës 1 të KPPK-së.

2) kundërshton dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë, pasi që nuk përmban tipare të veprës penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor, dhe vendimin e Gjykatës Supreme, që ndryshon cilësimin juridik (Neni 30 par. 2 pika 3 e LPK-së) pa sqaruar arsyet përkatëse. Mbrojta pretendon se të dy aktgjykimet përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale neni 403 par. 1 pika 1 dhe 11 e KPPK-së.

3) pretendon se cilësimi juridik i veprës penale duhej të ishte Lëndim i rëndë trupor neni 38 i LPK-së. **Prokurori i Shtetit në përgjigjen e tij** kërkon që Gjykata Supreme të refuzojë ankesën si të pabazuar dhe jep këtë analizë:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shtetit atakon aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës



mbi baza të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe ligjit penale.
Në veçanti,

1) GjS do të ketë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale: neni 386 par. 1 dhe 2 dhe neni 426 i KPPK-së. Edhe pse Prokurori i Shtetit nuk bëri ankesë ndaj aktvendimit të konfirmimit, Gjykata Supreme është dashur të bëjë cilësimin e vet të veprës penale dhe të zbatojë ligjin penal në faktet e kësaj lënde. Në vend të ri-cilësimit të veprës penale Vrasje në tentativë/Vrasje GjS-ja ri-cilësoi vetëm rrethanat rënduese.

2) Të dyja gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë shkelën nenin 19 të KPRSFJ-së pasi që kishte mjaft elemente për të konkluduar se kjo vepër penale nuk ishte vrasje në tentativë por vrasje pasi që dashja për të vrarë ishte vërtetuar drejt nga GjQ dhe GjS. Kjo e fundit duhej ta kishte pranuar ankesën e Prokurorit publik dhe ta kishte ri-cilësuar veprën penale si vrasje dhe ta dënonte të pandehurin në përputhje me këtë.

Arsyet

Përbërja e kolegjit të shkallës së parë

Vendimi shkallës së dytë ishte i drejtë kur potencon se kolegji shkallës së parë ishte i përbërë sipas ligjit nga tre gjyqtarë ndërkombëtarë të UNMIK-ut; faktikisht kolegji ishte themeluar në bazë të vendimit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm Soren-Jessen-Peterson, të lëshuar më 8 dhjetor 2004 sipas Rregullores së UNMIK-ut n° 2000/64 (të vazhduar deri më 15 dhjetor 2005 në përputhje me nenin 554 § 1 të KPPK-së me Rregulloret pasuese të UNMIK-ut 2001/34, 2002/20, 2003/36 dhe 2004/54).

Përbërja e kolegjit të shkallës së dytë


Kolegji i ankesave ishte i përbërë nga pesë gjyqtarë, dy Gjyqtarë të EULEX-it në GjS dhe 3 Gjyqtarë vendorë të GjS sipas vendimit të Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it më 18.01.2010

Avokati mbrojtës konfirmon se kolegji duhej të ishte përbërë nga tre gjyqtarë sipas nenit 4.7 të Ligjit mbi Kompetencat.

Madje edhe nëse argumenti se një kolegji prej pesë anëtarësh është garanci më e madhe për të pandehurin se një kolegji prej tre anëtarësh nuk është marrë parasysh, Gjykata Supreme është e mendimit se përbërja e kolegjit ishte sipas ligjit.

Për zgjidhje të drejtë të problemit të përbërjes së kolegjeve të EULEX-it (kolegjet e Gjyqtarëve të EULEX-it caktohen sipas Ligjit mbi Kompetencat dhe Rregullave mbi përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të miratuar nga Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it) duhet të merren parasysh elementet në vijim:

a) Rregullat kryesore mbi përbërjen e kolegjeve të EULEX-it mund të gjinden në nenin 3.7 LmK lidhur me lëndët me kompetencë primare apo ekskluzive dhe lëndët me kompetencë dytësore vendosur me nenin 3.3. dhe 3.4 LmK ("Kolegjet në të cilat Gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë kompetencat e tyre në ato procedura penale do të përbëhen nga shumica e gjyqtarëve të EULEX-it, dhe një gjyqtar i EULEX-it do të jetë kryetar i kolegjit.") dhe në nenin 4.7 LmK lidhur me lëndët me kompetencë dytësore që ka të bëjë me procedurën e përjashtimit ("Kolegjet në të cilat Gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë kompetencat e tyre në ato procedura penale në të cilat janë caktuar sipas dispozitave të paragrafëve 1-5 të këtij neni gjithmonë do të përbëhen



nga tre gjyqtarë, nga të cilët së paku dy janë gjyqtarë të EULEX-it dhe njëri nga gjyqtarët e EULEX-it do të jetë kryetar i kolegjit”)

b) Problemi i përbërjes së kolegjeve është i ndryshëm për kolegjet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme.

c) Lidhur me shkallën e parë dhe kolegjet e EULEX-it për ankesa në GjQ, çështja kryesore për t'u zgjidhur ka të bëjë me praninë e shumicës së gjyqtarëve laik në Gjykatat e Qarkut dhe Gjykatat Komunale për vepra më të rënda dhe shkallën e ankesës (neni 22 dhe 24 i KPPK-së).

Gjykata Supreme konsideron që kolegji i EULEX-it duhet të përbëhet vetëm nga gjyqtarë profesional të (EULEX-it dhe Kosovës) në bazë të argumenteve në vijim:

c1) KPPK-ja përcakton rregullën e shumicës së gjyqtarëve laik në përbërjen e zakonshme të kolegjeve

c2) LmK përcakton rregullën e shumicës së gjyqtarëve të EULEX-it

c3) LmK krijon juridiksionin dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it, përmban dispozita më specifike në krahasim me dispozitat e përgjithshme të KPPK-së lidhur me përbërjen e kolegjeve (lex specialis derogat generali, id est: kur dy apo më shumë ligje janë në kundërshtim, ligji më specifik ka përparësi ndaj ligjit të përgjithshëm).

c4) Rregulla për shumicën e gjyqtarëve të EULEX-it mbizotëron ndaj rregullën e shumicës së gjyqtarëve laik

c5) “Gjyqtari kosovar” në LmK “do të thotë banor i Kosovës i emëruar si gjyqtar sipas ligjit të aplikueshëm” (neni 1).


d) në pikën e numrit të anëtarëve të kolegjeve (për vepra të rënda dhe shkallën e ankesës) në nivelin e Gjykatës Komunale dhe Gjykatës së Qarkut, mungesa e gjyqtarëve laik ka ngritur çështjen se cili rregull duhet të zbatohet. Bazuar në argumentimin analogjik, rregulli i nenit 4.7 mund të zbatohet në të gjitha rastet e kompetencës sekondare sipas neneve 3.3., 3.4 dhe 4 (ato paraqesin të njëjtin “ratio legis” – për të siguruar funksionim korrekt dhe të paanshëm të drejtësisë me anë të zëvendësimit të gjyqtarit kosovar me gjyqtarin e EULEX-it) dhe për lëndët me kompetencë primare (ku vlerësimi i pranisë së nevojshme të gjyqtarëve të EULEX-it është bërë paraprakisht dhe në abstrakt me anë të ligjit në bazë të rëndësisë apo kompleksitetit të veprës penale).

e) Kolegjet e Gjykatës Supreme përbëhen nga pesë apo tre gjyqtarë profesional varësisht nga rëndësia e veprës apo shkalla e vendimit (neni 26 i KPPK-së). Në bazë të parimit *in claris non fit interpretatio*, kolegjet e EULEX-it duhet të përbëhen nga pesë apo tre anëtarë. Sipas nenit 3.7 të LmK-së, Kryetari i kolegjit duhet të jetë gjyqtar i EULEX-it dhe shumica e kolegjit duhet të jetë nga gjyqtarët e EULEX-it, nëse Kryetarja e Asamblesë nuk vendos ndryshe.

f) Përfundimi është se kolegjet e EULEX-it gjithmonë përbëhen nga tre gjyqtarë në shkallën e parë dhe ankesat e GjQ-së dhe nga pesë gjyqtarë varësisht nga rëndësia e veprës apo shkallës së vendimit në nivelin e Gjykatës Supreme.

Pranueshmëria e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit publik.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK), e datës 9 nëntor 2009, është regjistruar në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë më 10 nëntor 2009. Pasi që Aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës Supreme në Prishtinë, i datës 19 maj 2009, i është dorëzuar palëve dhe pasaçërisht të pandehurit më 29 korrik 2009, dhe kërkesa e ZPShK-së është regjistruar rreth 4 (katër) muaj më vonë, shtohet pyetja se janë veprimet e ZPShK-së të vjetruara apo jo,



sipas nenit 452, paragrafit 3, lidhur me nenin 443, paragrafit 1 të KPPK-së. Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të jurisprudencës së saj të konsoliduar, gjen se lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit publik, nuk lidhet me ndonjë afat kohor siç është përcaktuar me nenin 452, paragrafin 3 të KPPK-së. Neni 452, paragrafi 3 i KPPK-së imponon respektimi e atij termi *ndaj personave të listuar në fjalinë e fundit të nenit 443, paragrafit 1 të këtij Kodi*. Teknikisht termi “*person*” i referohet vetëm personave fizikë ose juridikë. Si pasojë, prokurori publik duhet të lirohet nga afati kohor i nenit 452, § 3 lidhur me nenin 443, § 1 të KPPK-së, pasi që prokurori publik, kur vepron në një lëndë, asnjëherë nuk vepron “personalisht”, që do të thotë si person fizik dhe gjithashtu secila zyre e prokurorit publik domosdoshmërisht është një organ shtetëror, por jo person juridik. Fakti i pakënaqshëm që si pasojë prokurori publik teorikisht mund të kërkojë për mbrojtje të ligjshmërisë edhe pas një periudhe disa vjeçare, për momentin mund t’i zvogëlohet rëndësia e saj sipas nenit 6, § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), e cila është pjesë e sistemit ligjor të Kosovës, për të drejtën në gjykim të drejtë dhe me kohë. Sidoqoftë, në këtë lëndë, vonesa në dorëzimin e Kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë siç është dërguar nga ZPShK-së ka qenë e arsyeshme dhe nuk ka pasur pasoja në kohëzgjatjen e gjykimit. Prandaj, ka nevojë që të merret parasysh.

Cilësimi i veprës penale.


Që të dy Avokati mbrojtës dhe Prokurori publik e kontestojnë cilësimin juridik të veprimit të kryer nga i pandehuri që është i përshkruar mirë në aktgjykimet e shkallës së parë she shkallës së dytë.

Sipas mendimit të të pandehurit gjyqtari i ankesës gabimisht ka cilësuar faktet si vrasje në tentativë, cilësimi i drejtë duhet të jetë – në mungesë të gatishmërisë së vërtetuar të vrasjes – lëndime të rënda trupore.

Në anën tjetër, Prokurori vërteton se kemi të bëjmë me një vrasjeje të kryer. Për ta mbështetur kërkesën e tij, Zyra e Prokurorisë (e cila nuk është ankuar nga konfirmimi i aktakuzës) nuk i dorëzon gjykatës arsye të reja ligjore. Thjesht i referohet mendimit mospajtues në vendimin e shkallës së dytë pa raportuar apo pranuar argumentet e tij kryesore dhe pa ia bashkangjitur dokumentin Kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë për ta bërë atë pjesë integrale të arsytimit të tij. Ato argumente nuk janë marrë parasysh.

Duhet nënvizuar se Gjykata nuk është duke u ballafaquar me problemin e fakteve. Siç është vërtetuar tanimë në vendimin e shkallës së dytë, faktet janë të vërtetuara mirë. Problemi është përfshirja e tyre nën dispozitat ligjore (lëndime trupore, vrasje në tentativë, vrasje). Në këndvështrimin faktik, është vërtetuar se, në kontestin e ashtuquajtur trazirat e marsit më 17 mars 2004 në Fushë Kosovë, i pandehuri, së bashku me persona të tjerë agresiv, kanë sulmuar viktimën me shufër metal - “me dy duart, sikur kur dikush do ta përdorte sëpatën për të qarë dru” - ; viktimë ka rënë në hendek dhe nuk ka qenë gjendje të lëviz përsëri dhe i pandehuri – së bashku me të tjerët – e kanë penguar policinë që ta shpëtojnë viktimën dhe ta dërgojnë në spital për trajtim të duhur mjekësor. Më vonë të njëjtën pasdite (nuk ka qenë e mundur të vërtetohet korniza kohore) viktimës i është vënë zjarr dhe ka vdekur si pasojë e drejtpërdrejtë e “hypoxia tisularis për shkak të mungesës së oksigjenit dhe pranisë së monoksidit të karbonik gjatë zjarrit”

Qëllimi i të akuzuarit dhe i bashkëkryerësve të tij të panjohur ka qenë qartazi i



drejtuar për ta vrarë viktimën e sulmit. Ky përfundim është bazuar në modalitetet e veprimit, në mjetet e përdoruar për realizimin e tij (shufrat/shkopinjë), në sjelljen pas rrahjes. Të gjitha këto elemente faktike bashkohen në demonstrimin e gatishmërisë për të vrarë.

Kjo e përjashton mundësinë për cilësimin e fakteve si lëndime të rënda trupore. Pastaj, duhet të vërtetohet nëse kemi të bëjmë me një vrasje të kryer apo të një vrasje në tentativë.

Në supozimin e Zyrës së Prokurorit, cilësimi i drejtë i veprës penale është “vrasje e kryer” në bazë të faktit se pasojat e traumës së rrahjes do të jenë të mjaftueshme për ta provokuar vdekjen e viktimës.

Në bazë të raportit mjeko-ligjor dhe në ekzaminimin e dëshmitarit ekspert, mundë të vërtetohet se: viktimja ka marrë lëndime të rënda të shkaktuara nga goditjen në kafkë; kur atij i është vënë zjarri, ai ka qenë ende i gjallë (“disa nga djegiet e vërejtura tregojnë reagimet vitale, që do të thotë se personi ka qenë ende gjallë gjatë djegies. Ju mund t’i shihni reagimet nga indet që mund të jenë të pranishme vetëm kur jeni i gjallë, po të ishit i vdekur ju nuk do të bëni ndonjë reagim”); ai e ka humbur vetëdijen dhe është djegur deri në shkallën e karbonizimit.

Do të thotë që – edhe nëse trauma ka qenë mjaft e ashpër për të qenë shkaktar autonom i vdekjes – pas rrahjes ka ndërhyrë një ngjarje e paparashikueshme e mjaftueshme për ta shkaktuar vdekjen.

Për t’iu shmangur shtesave të njohura mirë të teorisë së ekuivalencës, neni 14 i KPK-së (Personi nuk është penalisht përgjegjës kur mungon lidhja shkakore midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave ose kur nuk ka mundësi të shkaktohen pasojat duhet të interpretohet në atë mënyrë që vargu shkakor ndërpritet (dhe lidhja shkakore ndërpritet) kur ka ndërhyrje (sikur ajo e përshkruar më lartë) të ngjarjeve të rastësishme të pavarura. Në këtë rast autori i veprimit i cili drejtpërdrejtë ka provokuar ngjarjen është përgjegjës për krimin e kryer ndërsa ai që e ka iniciuar lidhjen e ndërprerë shkakore do të jetë përgjegjës për veprimet e kryera apo mosveprimet nëse janë realizuar të gjitha elementet e veprës penale.

Në lëndën e ekzaminuar nga gjykata, të gjitha elementet e vrasjes në tentativë janë mbledhur me kohë.

Si rrjedhojë, të dy kërkesat për ri-cilësim të veprës penale të Prokurorit dhe të avokatit mbrojtës duhet të refuzohen.

Dispozitivi i aktgjyimit të shkallës së parë dhe arsytimi i vendimit të shkallës së dytë.

Dispozitivët e shkallës së parë dhe shkallës së dytë (si tërësi me aktgjykimet) janë të kuptueshme.

Gjykata Supreme, në aktgjykimin e ankimuar, ka arsytuar në mënyrë të logjikshme. Në mënyrë precize ka sqaruar arsyet për aplikimin e elementeve të ndryshme rënduese dhe për mbajtjen e cilësimit të krimit si vrasje në tentativë.

Nuk është bërë asnjë shkelje e KPPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS në Prishtinë

Pkl-Kzz 119/09



Mendim pjesërisht mospajtues i Gjyqtarit Gerrit-Marc Sprenger në pajtim me nenin 420, paragrafi 3 i KPPK-së:

Kolegji i Gjykatës Supreme mbi mbrojtjen e ligjshmërisë nuk ka qenë në gjendje të marr vendim unanim lidhur me çështjen, nëse, nëse lënda në fjalë është kualifikuar si Vrasje (e rëndë) ose si Vrasje (e rëndë) në Tentativë. Përkundër pyetjes, se ka rrethana rënduese të vërtetuar dhe e cila nuk është objekt i mendimit mospajtues, kualifikimi i krimit si vrasje e kryer apo vrasje në tentativë varet nga diskutimi i vështirë ligjor për kausalitetin dhe përgjegjësinë penale.

Edhe pse unë pajtohem me të gjitha vendimet tjera të kolegjit, unë me respekt nuk pajtohem me vendimin e shumicës së kolegëve të mi për të kualifikuar krimin e kryer nga i akuzuari vetëm si vrasje në tentativë. I akuzuari qartë ka kryer vrasje të plotë.

Prej argumenteve të deritanishme unë para se gjithash i referohem mendimit mospajtues të Gjyqtarit Norbert Koster, që ishte i bashkangjitur aktgjykimit të shkallës së dytë (Ap.-Kz. nr.165/2007). Posaçërisht duket bindës argumenti, pse i akuzuari duhet të përfitojë prej zjarr vënies apo zjarrvënies prej rrahjes, që do të ishte rast nëse të dytë do të ishin të dënuar vetëm për tentativë, vetëm pse atje ishte i përfshirë gjithashtu një kryes tjetër i pavarur.

A. Problemet e kausalitetit dhe përgjegjësia penale:


Megjithatë, pyetja e përgjegjësisë varet në mbledhjen e kausaliteteve në lëndën në fjalë e cila bazohet në faktet vijuese:

I. Situata faktike:

I akuzuari, së bashku me bashkë-kryesit e paidentifikuar, ka rrahur viktimën duke e përdorur shufrën e hekurt aq rëndë sa që viktima ka marrë thyerje të rënda të kokës dhe ka rënë në hendek, kështu që nuk ka qenë në gjendje të lëvizë. Pas një kohe, një kryes i paidentifikuar derdhi benzinë mbi viktimën që ishte ende gjallë dhe e dogji.

Bazuar në raportin e autopsisë të datës 17 mars 2004, eksperti i mjekësisë ligjore deklaroi me 13 korrik 2004 para Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë dhe e përshkroi shkakun e vdekjes së viktimës siç vijon:

“ ... Personi “ ka vdekur si rezultat i Shokut Neurogjenik për shkak të shembjeve trunore, për shkak të tronditjeve të dhunës së hapur në kokë dhe hipoksisë (*hypoxia*) për shkak të mungesës së oksigjenit dhe pranisë së monoksidit të karbonit gjatë zjarrit ” (Shënim i ekzaminimit të dëshmitarit ekspert, i datës 13 korrik 2004, fq. 6). Viktima kishte marrë “së paku pesë goditje ” (fq.6). Gjithashtu, “lëndimet e vërejtura të shkaktuara nga goditja në kafkë dhe tru kanë qenë mjaft të rënda të shkaktojnë vdekjen e personit, duke e lënë anash zjarrin. Nga kjo domethënë që vetëm këto lëndime mund të jenë shkaktoresh të vdekjes (fq.7). Me kërkesën e Prokurorit Publik, eksperti ka deklaruar se kombinimi i të



goditurave ka mundur të jetë fatal, “por gjithashtu vetëm një e goditur duke shkaktuar thyerjen e kafkës do të mund të ishte fatale” (fq.8).

Gjatë seancës së 07 korrik 2005, deklarata e këtij dëshmitari ekspert ishte lexuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor nga kolegji i shkallës së parë sipas nenit 156, paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), (fq.2). [Në këtë prapaskenë duket mjaft befasuese dhe duket se aktgjykimi i shkallës së parë të jetë i papajtuëshëm në vete kur në arsyetimin e dënimit për vetëm vrasje në tentativë më vonë thotë: “*Vepra nuk është kryer, sepse prej raportit mjeko-ligjor nuk është vërtetuar përfundimisht që viktimja ka vdekur si rezultat i drejtpërdrejtë i goditjes së shkaktuar në te nga i akuzuari*” (fq.22)].


II. Problemi ligjor i teorive të kazualitetit:

Në kontekstin e problemeve të kazualitetit, një numër i teorive të kazualitetit është zhvilluar dhe shumë mirë janë pranuar në shumicën e traditave penale kontinentale e gjithashtu edhe atyre të ligjit civil në Evropë.

Posaçërisht **teoria e ekuivalencës** si teori elementare e shkakut të ligjit penal, domethënë që kazualiteti ndodh nëse është paraqitur kushti, pa të cilin rezultati penal nuk do të mund të përfundonte (*condition sine qua non*), është i shtrirë plotësisht në sistemet ligjore kontinentale. Kjo është përmbushur nga **teoria shumë e pranuar e përshtatshmërisë**, e cila së pari është zhvilluar në fushat e ligjit civil, duke propozuar që kushti është shkak i përshtatshëm i dëmit nëse është i atij lloji që ngrit mundësinë objektive të dëmit të një sasive të konsiderueshme (përveç shumë të tjerëve: Wessels, Johannes/Boulke, Werner, Strafrecht (Allgemeiner Teil), botimi i 32^{te}, Heidelberg 2002, fq. 53 f. dhe – për ligjin civil - Liu, Xinping; Studimi i teorisë së kazualitetit në Dëme (Abstrakt); gjendet nën http://www.lawgd.com/en/news_show.asp?id=1141, e gjetur me 25 janar 2010).

Në pajtim me këto teori, e cila është e rëndësishme për lëndën në fjalë, **Gjykata Supreme e Jugosllavisë** ka nxjerr në pah se “*Kazualiteti si lidhje objektive në mes të veprimit të njeriut dhe të pasojës ekziston në sferën e ligjit penal jo vetëm aty ku veprimi inkriminues përmbush kërkesën e drejtpërdrejtë për të sjellë pasojën e ndaluar, por gjithashtu kur një veprim i tillë, së bashku me veprimet e personave tjerë ose kërkesat e llojeve tjera, ka kontribuar në materializimin e pasojës së ndaluar, kështu që ajo paraqitet sikurse shkak i saj*” (Gjykata Supreme e Jugosllavisë, Vendimi Kz-36, i datës 17 qershor 1969, në *Zbirka sudskih Odluka, Sluzbeni list SFRJ*, Beograd, nr. 3/1969, f. 134 (e cituar sipas Igor Vukovic, “Zbatimi i Teorisë së Ekuivalencës në Ligjin Penal: Disa çështje me interes” në: *Analet e Fakultetit Juridik në Beograd(2007)*; fq. 151-163 (157), shënimi në fund të faqes 21; to gjendet nën <http://www.ius.bg.ac.yu/Anali/Annals%202007/Annals%202007%20pg%20151-163.pdf> e gjetur me 25 janar 2010).

III. Kazualiteti në lëndën në fjalë:



Duke pas parasysh teoritë elementare të kazualitetit të lartpërmendura, për lëndën në fjalë disa konstruksione të kazualitetit, që na shpijnë në rezultate të ndryshme, duhet të konsiderohen siç janë dhënë:

1) Lënda në fjalë është në mënyrë të qartë **jo lëndë e kazualitetit hipotetik**, e cila do të ishte e ndaluar për tu marrë në konsideratë. Lënda sipas së cilës kryesi i veprës e mbyt viktimën e tij/saj, por viktimja, nëse nuk do të ndodhte vrasja, megjithatë do të mund të vdiste disa minuta më vonë (për shkak se aeroplani i tij/saj eksplodon menjëherë pas nisjes) nuk është dhënë. Kjo në lëndën në fjalë nuk do të ishte e mundur të konsiderohet se megjithatë viktimja për shkak të zjarrit ka vdekur dhe kështu zjarr vënia nga i akuzuari nuk mund të merret si veprim që vendos arsyen përfundimtare për të vdekurin.

2) Kuptimi i rrezikut, i cili është vendosur nga të dy kryesit e krimit, sipas mendimit tim gjithashtu **nuk mund të konsiderohet vetëm si kazualitet i rastit (anësor)**, që mund të jetë rasti nëse zinxhiri i kazualitetit është ndërprerë, respektivisht nëse vdekja e viktimës është shkaktuar prej tij vetëm duke e djegur, ashtu që lëndimet e marra duke e rrahur me shufër metalike kanë mbetur pa kurrfarë efekti. Në këtë rast, Mehmet Morina me të vërtetë do të ishte përgjegjës vetëm për vrasje në tentativë, përderisa kryesi i dytë i panjohur, i cili e ka djegur viktimën, ka kryer vrasje të plotë.


3) Në lëndën në fjalë, sipas analizave të autopsisë dhe të deklaratës së ekspertit të mjekësisë ligjore, viktimja ka vdekur si rezultat i të dyjave, zjarr vënies në kokë, por megjithatë do të vdiste si rezultat i lëndimeve të kokës dhe të kafkës/trurit të pësuar vetëm prej shufrës metalike. Bile, vetëm një prej këtyre lëndimeve do të shkaktonte vdekjen e viktimës. Për shkak të kësaj, lënda në fjalë duhet **të konsiderohet si lëndë e shkakut të dyfishtë** dhe si pasojë e veprimeve penale të të dy kryesve, Mehmet Morinës e gjithashtu të kryesit të paidentifikuar deri më tani që e ka djegur viktimën, duhet të kualifikohen si vrasje të plota.

IV. Kazualiteti dhe ana subjektive e veprës së të pandehurit:

Në përputhje me rrethanat, neni 13 i Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ) përcakton si në vijim:

Vepra penale është e paramenduar nëse i kryesi është i vetëdijshëm për veprën e tij dhe e dëshiron kryerjen e saj; apo kur ai është i vetëdijshëm që shkakun i ndaluar mund të pasojë prej veprimit ose mosveprimit të tij dhe pajtohet me të.

Në lëndën në fjalë, i pandehuri jo vetëm që e ka lënduar aq rëndë viktimën duke e rrahur atë disa herë me shufër metalike në kokë dhe kafkë ashtu që viktimja ka rënë në hendek duke mos qenë i aftë të lëvizë përsëri dhe ka mundur të vdiste nga këto lëndime gjithashtu duke e lënë anash zjarrin, i cili më vonë i është vënë atij. I pandehuri – së bashku me të tjerët – pas rrahjes së viktimës gjithashtu ka penguar **policinë për të shpëtuar viktimën dhe ta sjell atë në spital për trajtim të duhur mjekësor.**



Qëllimi për të lënë viktimën vetëm me fatin e tij të pashmangshëm, nuk mund të bëhet më i qartë, kështu duke pasur parasysh se në atë kohë viktima ishte i lënduar keq ishte i shtrirë në tokë dhe i paaftë të lëvizë.

B. Përfundimi:

Si përfundim, Unë besoj se nuk ka pasur zgjidhje tjetër përveç se i pandehuri të shpallet fajtor për vrasje të plotë dhe ta dënohet në përputhje me rrethanat.

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar penal në Gjykatën Supreme të Kosovës

